

L I G J
Nr.8442, datë 21.1.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8389, DATË 5.8.1998 "PËR SHTETËSINË SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 7 i ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare" ndryshohet si vijon:
"Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare."

Neni 2

Neni 16 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:
"Për të miturit, shtetësia shqiptare mund të mbarojë kur të paktën njëri nga prindërit ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Në këtë rast kërkohet pëlqimi i të dy prindërve."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2299, datë 26.1.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**